

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Në mars 1945, Enver Hoxha thërriti Delegatin Apostolik Nigris', historia e panjohur e ish-ambasadorit të Vatikanit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/dossier/ne-mars-1945-enver-hoxha-therriti-delegatin-apostolik-nigris-historia-e--i586147
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 06:17:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1550d7a0be83848da7e3d2ff41b806275c09fe81b6861af365bf7ef92253a83a
TEKSTI	4aba5fd46fd2b3e1d220a0981c4198b0e98b29dba616615439ec2439119ade37
PAMJA	54ff60d78fac8a6de9ac1b216b23678232b94ac169eb90149d9c1fc2ee20f9bd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d7bfbf7ee823d319e523ffc2a3cab0d3a145cfa905909a5092a7e77d85c69d88
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	07dcd14af433ca62f57d8764b5c6075704d5b7e87042b539795708e53d505cef
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d7bfbf7ee823d319e523ffc2a3cab0d3a145cfa905909a5092a7e77d85c69d88>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie 'Ne mars 1945, Enver Hoxha thërriti Delegatin Apostolik Nigris', historia e panjohur e ish-ambasadorit të Vatikanit Makina e vjedhur digjet në tunel/ Vlore, Policia në ker fundit

‘Në mars 1945, Enver Hoxha thërriti Delegatin Apostolik Nigris’, historia e panjohur e ish-ambasadorit të Vatikanit



15 Shtator 2026, 08:05 Dossier TEMA



Në kohën e rrokopujës ballkanike dhe botërore, në Selinë Diplomatike në Shqipëri, në vitin 1938 erdhi Delegati Apostolik, Leone Nigris. Ai lindi në Ampezzo (Carnia) në vitin 1884. Pas shkollimeve në Uddine, u shugurua meshtar në 1908. Më pas ishte profesor i Letërsisë në Seminar të Uddines dhe në vitin 1929 u zgjodh kanonik-gjyqtar në metropolin e Uddines.

Ai shquhej për botimin e disa librave në fushën teologjike. Për shkak të zgjuarsisë që kishte, Papa Pio XI, në vitin 1938 e emëroi Delegat Apostolik në Shqipëri. Ardha e tij zyrtare në Shqipëri, shënohet më 16 tetor 1938, duke zbarkuar në orët e mëngjesit me anije në Durrës, i shoqëruar nga sekretari i Dërgatës Apostolike në Shqipëri, Dom Nikollë Gjinaj.

Në Durrës, krahas besimtarëve të shumtë, u prit nga Imzot Pjetër Gjura, kryepeshkv i Durrësit dhe famullitari Dom Anton Zogaj e, famullitari i Tiranës, Dom Shtjefën Kurti. Duke vazhduar rrugën për në Selinë e tij në Shkodër, Delegati Apostolik Nigris, në ora 12, arriti në Milot dhe Gurrës. Në Lezhë, vizitoi Qendrën Jetimore të Etërve Françeskanë, ku me këtë rast u recitua poezia e poetit Ndre Mjeda, “Lissus”.

Nga Lezha për në Shkodër i shoqëruar nga besimtarët të cilat e përshëndesnin gjatë rrugës, Nigris u ndalua pran Kalasë Rozafa në Shenjtëroren “Zoja e Këshillit të Mirë”, për ta vazhduar rrugën për në Katedralen e Shkodrës, ku u prit nga qindra besimtarë dhe hierarkia e lartë kishtarë, Imzot Gaspër Thaçi e ipeshkvijtë të tjerë. Leone Nigris si diplomat i fundit, qëndroj në Shqipëri deri më 11 tetor vitit 1945.

Ngjarjet kishtarë dhe politike në Shqipëri

Nigris, në jug të Shqipërisë nga viti 1939, vepronte në cilësinë e ordinariatit, për Administraturën Apostolike të Jugut, duke themeluar disa famulli dhe shumë qendra misionarësh. Ai i propozoi Selisë së Shenjtë transferimin e Zyrës Apostolike nga Shkodra në Tiranë, për arsye se do ishte më e volitshme prania e Delegatit Apostolik në kryeqytet si qendër, sesa në Shkodër që ishte skaj i Shqipërisë.

Ndërkohë që rreth kësaj çështjeje po zhvilloheshin bisedimet, ndodhi që natën e 18 dhjetorit të vitit 1943, të digjet Selia Apostolike në Shkodër. Përgjigja e autorizimit vonoi të vinte dhe ndërkohë erdhi pushtimi ushtarak i 7 prillit (1939), që e bëri të vështirë problemin e blerjeve të shtëpive në kryeqytet, duke mbetur kështu pezull ideja e tij.

Në Arkivin Sekret të Vatikanit, Nigris, ka dy relacione shumë të rëndësishme për vendin tonë dhe jetën kishtarë. Në një nga relacionet e dt. 11, tetor 1945, ndër të tjera ai rrëfen se, "Ipeshkvijtë e Arbërisë, janë të mirë, por nuk mund të thuhet se ishin në lartësinë e mandatit të tyre! Numri i Dioqezave ishte i tepërt! Gjashtë Ipeshkvij mbi rreth 120 meshtarë shekullarë dhe rregulltarë!" "Shenja dominuese e klerit", – thekson Nigris, – ishte plogështia baritore. Populli kishte një tendencë të theksuar për politikanizëm, një dhënie e dukshme pas parasë!"

"Krye-dioqeza e Tivarit, – thotë Nigris, – ishte në gjendje të mjerueshme, kurse ajo e Shkupit (e cila përfshinte dhe Kosovën) me probleme sociale". Në relacionin e dt. 1 janar 1945, për periudhën 1938-1944, dërguar Papa Pio XII, Nigris flet gjerësisht për situatën politike dhe shprehet se, "gjatë pushtimit italian vizitova katër kampe të burgosurish grekë dhe jugosllavë; gjatë pushtimit gjerman u interesova për të burgosurit dhe për qytetarët italianë. Si në regjimin italian, ashtu dhe gjatë pushtimit gjerman, iu bëra mbrojtës hebrenjve".

Në mbyllje të relacioneve të tij, Leone Nigris thotë: "Kështu u mbyll në mënyrë drastike një periudhë prej gjashtë vitesh e gjysmë mjaft e gjallë, me pasimin e katër regjimeve të kundërt mes tyre: 3 luftëra, 2 pushtime ushtarake, luftë civile, një seri Qeverish antagoniste kryesisht me bazë ambicionesh personale, një vazhdimësi e 'tour de force' për të ruajtur ekuilibrin dhe për të mos kompromentuar Përfaqësinë e Selisë së Shenjtë, pa numëruar aventurat e shumta të rrezikshme personale", përfundon Nigris.

Dëbimi

Në fund të marsit 1945, Enver Hoxha thërret Delegatin Apostolik Nigris, duke i kërkuar që të shkojë në Romë dhe t'i paraqesë Papës Pio XII dëshirën e Qeverisë Shqiptare, për të pasur marrëdhënie diplomatike me Vatikanin. Por ky udhëtim i diplomatit të Vatikanit që pa kthim, sepse i qe ndaluar kthimi në Shqipëri.

Ky ishte momenti kur Shqipëria ia mbylli dyert për dyzet e pesë vite me radhë Papatit, qytet-shtet në Romë, apo Selisë së Shenjtë, që është shteti virtual me juridiksion në të gjithë botën e i njohur ndërkombëtarisht, i cili ka marrëdhënie diplomatike me 178 shtete të botës.

Shqipëria i mbylli portën mikut të çmuar, i cili në shekujt e vështirë, ka ndihmuar Shqipërinë dhe shqiptarët, në fushën sociale, politike e arsimore, deri në largimin përfundimtar të diplomatit të vyer Leone Nigris, i cili, sikur pas vetes la mallkimin hyjnor, duke na mbuluar më pas mortja e zezë e komunizmit.

Pas largimi të tij në janar të vitit 1945, nga regjimi i Enver Hoxhës, rolin formal të delegatit Apostolik e luante Imzot Frano Gjini, ipeshkëv i Abacisë së Mirditës, deri në pushkatimin e tij në zallë të Kirit, në vitin 1948. Si rezultat i komunizmit ateist, bilanci ishte: krahas shkatërrimeve e konfiskimeve të objekteve fetare, shënohet se shumë pak klerikë kishin mbetur ende gjallë. Sipas një statistike mësohet se gjatë periudhës (1945-1980) kur regjimi komunist erdhi në fuqi, kishin vdekur nëpër burgjet e shtetit, 2 argjipeshkvi, 5 ipeshkvi, 1 abat, 65 priftërinj dioqezanë, 33 françeskanë, 14 jezuitë, 10 seminaristë dhe 8 murgesha.

Me ndryshimet e mëdha që ndodhën në Shqipëri në fillim të viteve '90, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut dhe futjen e pluralizmit politik në vendin tonë, u bë e mundur që të fillonin kontaktet e para me Selinë e Shenjtë, me Shtetin e Vatikanit. Si rezultat i bisedimeve që vendosja e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Shtetit të Qytetit të Vatikanit, më 7 shtator 1991 në nivel ambasadorësh.

Selia e Shenjtë ka akredituar pranë qeverisë shqiptare në vitin 1992, Nuncin e parë Apostolik, Imzot Ivan Dias; në vitin 1997, Nuncin Imzot, Giovanni Bulaitis dhe në vitin 2008 e në vazhdim, Nuncin Apostolik të Selisë së Shenjtë, Imzot Ramiro Moliner Ingles. Ndërsa në vitin 1992, ambasadori i parë shqiptar pranë Selisë së Shenjtë, ishte z. Wili Kamsi. Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes të Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, u krijuan mundësitë për rritjen e bashkëpunimit dypalësh.

Një pikë kulmore është vizita e Papës Gjon Pali II në Shqipëri, më 25 prill 1994. Atit të Shenjtë iu rezervua një pritje e shkëlqyer dhe madhështore nga populli shqiptar. Vizita e Shenjtërisë së tij që një mbështetje morale dhe politike për Shqipërinë. Le të shpresojmë se ardhja e Papa Françeskut, më 21 shtator në Shqipëri do ketë po aq jehonë sa e Papa Gjon Palit II dhe do shërbejë më tej, përveç diplomacisë, edhe në marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e kulturës, arsimit, shëndetësisë dhe ngritjes shpirtërore të popullit tonë./ Memoria.al

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Baba Medin Gllava: Kleriku bektashi që e ktheu teqenë në shkollë dhe repart për strehimin e çetës së tij patriotike.

15:04 Dossier / 3 komente

EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "aferën e armëve" me Shqipërinë. Si Berisha shkatërroi PPD-në përmes skemave të shërbimit maqedonas

15:30 Dossier / 13 komente

17:58 Dossier / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.